



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1136/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Vjollca Kabashi kandidate për asamblenë komunale në Prizren nga koalicioni AAK-LDD, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Vjollca Kabashi kandidate për asamblenë komunale në Prizren nga koalicioni AAK-LDD,

URDHËROHET KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimin 2014A/02D dhe ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Vjollca Kabashi kandidate për asamblenë komunale në Prizren nga koalicioni AAK-LDD, në të cilën pretendon se në VV 2014A/02D në FRK ka 5 vota kurse në rezultatin përfundimtar të QNR-KQZ-së ka 0 vota.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga dëshmitë e ofruara është vërejtur se ka pasur parregullsi pasi që në FRK ka 5 vota ndërsa nga rezultati i QNR-së rezulton ti ketë 0 vota, andaj urdhërojmë që të bëhet rinumërimi në këtë VV. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më

qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa
A nr. 1136/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osman



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i